



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 523 Prot.

Tiranë, më 29 / 05 / 2014

**Lënda :** Dërgohet rekomandim për marrjen e masave për ofrimin e shërbimeve të gjëndjes civile në baza të barabarta (në mënyrë të ngjashme) dhe mbrojtjen e identitetit të fëmijës së lindur jashtë martese.

**Drejtar :** **DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË GJËNDJES CIVILE**

**TIRANË**

**Për dijeni:** **Z. Saimir TAHIRI**  
**MINISTËR**  
**MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**

**TIRANË**

Pranë institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i cili në bazë të ligjit nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, është institucion i cili siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo sjellje që nxit diskriminimin, ka paraqitur një ankesë organizata joftimprurëse Qëndra për Nisma Ligjore Qytetare.

Konkretnisht bëhet fjalë për lëshimin nga ana e zyrës së gjëndjes civile pranë Njësisë Bashkiake Nr. 11, Tiranë, të certifikatës së lindjes përfunduese që fëmijët e mitur Klea Koleci, një fëmijë e lindur jashtë martese, e cila në rubrikën e përbërësve të gjëndjes civile “emri i babait” ka të shënuar “Xx”. Për zgjidhjen e këtij problemi qëndra i është drejtar Zyrës së Gjëndjes Civile pranë Njësisë Bashkiake Nr.11 Tiranë, duke kërkuar që të shënohet përkohësisht si atësi përfundues i emrit i babait i deklaruar nga nëna, me shënimin se është e dhënë e deklaruar nga nëna. Sipas përgjigjes së zyrës së gjëndjes civile ata kanë vepruar në bazë të ligjit duke refuzuar kërkeshë. Pasi nuk kanë



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

gjetur zgjidhje me shkresën nr. 272 prot datë 29.04.2013, QNL, i është drejtuar institucionit tuaj, jo vetëm për zgjidhjen e rastit konkret, por edhe marrjen e masave për unifikimin e praktikës së punës të Zyrave të Gjëndjes Civile, për këto raste. E njëjtë kërkesë, pa marrë përgjigje nga ana juaj, ju është përsëritur nga ana e QNL, me shkresën nr. 298 prot datë 08.01.2014.

Në analizë të legjisacionit në fuqi kombëtar dhe atij ndërkombëtar, Komisioneri, vlerëson se praktika e ndjekur nga shërbimi i gjëndjes civile pranë Njësisë Bashkiake Nr. 11, Tiranë, nuk është e bazuar në ligj, dhe shkakton vendosjen në kushte të pabarabarta të fëmijëve të lindur jashtë martese në raport me fëmijët e lindur nga martesa, duke mos e ofruar shërbimin për të cilën është ngarkuar me ligj në mënyrë të ngashme, për shkak të statusit të këtyre fëmijëve, lindjes së tyre jashtë martese.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, që është akti me fuqinë më të lartë në Republikën e Shqipërisë, sanksionon se fëmijët gjëzojnë mbrojtje të veçantë nga shteti dhe se fëmijët e lindur jashtë martese kanë të drejta të barabarta me të lindurit nga martesa<sup>1</sup>. Vendi ynë ka ratifikuar në datë 27.02.1992 Konventën e Kombeve të Bashkuara “Për të Drejtat e Fëmijës”<sup>2</sup> dhe në vitin 2010 ka miratuar ligjin “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”, ku sanksionohet e drejta e fëmijës për të ruajtur identitetin e tij<sup>3</sup>.

Sipas nenit 2, të ligjit nr. 10 129, datë 11.5.2009 “Për gjëndjen civile”, të ndryshuar, përbërësit e gjëndjes civile, janë të gjitha elementet e përcaktuara në këtë ligj, që shërbejnë për përcaktimin e identitetit të çdo shtetasi, dhe në bazë të nenit 6, të këtij ligji, raporti i atësise është një ndër përbërësit e gjëndjes civile.

Tërësia e elementeve që përbëjnë gjëndjen civile të një individi administrohen në dokumentacionin që administron dhe lëshon shërbimi i gjëndjes civile. Çertifikata e lindjes është një nga dokumentet bazë që lëshon zyra e gjëndjes civile, dhe është një dokument që kerkohet për identifikimin e fëmijës në shumë situata, si gjatë arsimimit të tyre, ashtu edhe në shumë

<sup>1</sup> Neni 54 i Kushtetutës; “Fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënët e reja kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti. 2. Fëmijët e lindur jashtë martese kanë të drejta të barabarta me të lindurit nga martesa.....”

<sup>2</sup> Neni 8 i Konventës Për të drejtat e fëmijës parashikon: “I. Shtetet palë marrin përsipër respektimin e të drejtës së fëmijës për të ruajtur identitetin e tij, duke përfshirë këtu shtetësinë, emrin dhe lidhjet familjare që njihen me ligj pa ndonjë ndërhyrje të paligjshme.....”

<sup>3</sup> Neni 7, pika 2 e ligjit nr. 10 347, datë 4.11.2010 “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës” parashikon: “Fëmija ka të drejtë të ruajë identitetin, përfshirë përcaktimin e mbiemrit, fitimin e shtetësisë dhe njohjen e lidhjeve familjare, në përpunje me legjisacionin në fuqi, pa ndërhyrje të paligjshme.”



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

marrëdhënie të tjera. Në rastin e fëmijëve të lindur nga martesa, çertifikata që lëshohet nga zyra e gjëndjes civile ka gjithmonë të plotësuar emrin e babait, gjë që nuk ka ndodhur në rastin e fëmijës Klea, e cila në çertifikatën e lindjes ka të shënuar tek rubrika “emri i babait” shënjën “Xx”. Pra për shkak të statusit të Kleas, si një fëmijë që ka lindur jashtë martese, asaj nuk i është ofruar një nga shërbimet e gjëndjes civile në mënyrë të ngjashme me një fëmijë të lindur nga martesa, duke bërë që ruajtja e identitetit të fëmijës së lindur jashtë martese të mos garantohet si në rastin e fëmijës së lindur nga martesa, duke e vendosur në këtë mëyrë këtë fëmijë në pozita të pabarabarta me fëmijët e lindur nga martesa.

Refuzimi për të shënuar përkohësisht si atësi për Klean, emrin e babait të deklaruar nga znj. Marjana Koleci, nëna e Kleas, përveçse vendos në kushte jo të favorshme Klean për shkak të statusit të saj si fëmijë e lindur jashtë martese, por në vlerësimin tonë, është edhe në zbatim të gabuar të ligjt “*Për gjëndjen civile*”.

Në nenin 37, të ligjit parashikohet: **“1. Kur e dhëna, që kërkohet për aktin e lindjes dhe të vdekjes, është e pamjaftueshme ose nuk vërtetohet nga deklaruesi, verifikohet pjesa përkatëse pranë organit, që ka dijeni për faktin juridik, përveç rasteve të shënimeve të përkohshme, sipas këtij ligji. 2. Me vërtetimin e së dhënës apo caktimin përfundimtar, bëhet plotësimi vetëm në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.”**

Në momentin e mbajtjes së aktit të lindjes, deklarimi i lindjes së Kleas është bërë vetëm nga nëna e saj Marjana dhe atësia e fëmijës Klea si fëmijë e lindur jashtë martese vertëtohej vetëm nëse babai do të deklaronte para nëpunësit të gjëndjes civile se njihte atësinë e Kleas. Nëse në momentin e deklarimit të lindjes, nëna do të kishte deklaruar një emër të përkohshëm si atësi të fëmijës, zyra e gjëndjes civile do të kishte bërë shënimet përkatëse sipas deklarimit të nënës, por gjëndja civile refuzon të shënojë një emër të përkohshëm si atësi të fëmijës në një moment të dytë, pasi është mbajtur akti i lindjes.

Nga dispozita e mësipërme nuk rezulton që ligji të ketë vendosur ndonjë afat se kur mund të bëhen shënimet e përkohshme. Nëse gjëndja civile do të pranonte deklarimin e nënës në momentin e deklarimit të lindjes, nuk ka asnje pengesë ligjore që ajo të pranojë të shënojë përkohësisht si atësi të fëmijës emrin e deklaruar nga nëna në këtë moment, pas hartimit të aktit të lindjes. Në këtë rast nuk kemi të bëjmë me njohje të atësisë së fëmijës Klea, pasi nëna e Kleas në këtë rast nuk pretendon vërtetimin e atësisë. Në shumë raste mund të ndodh që nënët që lindin fëmijë jashtë martese të mos kenë dijeni, se ato kanë të drejtën të deklarojnë një emër të përkohshëm si atësi të fëmijës, dhe për pasojat që mund të sjellë një mosdeklarim i tillë. Mosdijkenia e nënave nuk mund të sjellë pasoja të tillë në të drejtat e fëmijës për të patur dhe ruajtur një identitet të tyre. Ligji “*Për gjëndjen civile*” nuk vendos pengesa të tillë ligjore dhe



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

gjëndja civile nuk mundet që në interpretim të gabuar të ligjit të vendos në pozita të pabarabarta fëmijët që kanë lindur jashtë martese.

Në kushtet kur një fëmijë trajtohet në mënyrë më pak të favorshme sesa një fëmijë tjetër, në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në statusin e tij si fëmijë i lindur jashtë martese, në bazë të nenit 3 të ligjit “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*” përbën diskriminim të drejtpërdrejtë.

Nuk ka asnje qëllim të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkontaktore të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi, që mund të përligjte në bazë të nenit 6 të ligjit “Për Mbrotjen nga Diskriminimi” këtë diferençë në trajtim të fëmijëve të lindur jashtë martese. Përkundrazi, Kushtetuta sanksionon se fëmijët gjëzojnë një mbrotje të veçantë dhe thekson barazinë e fëmijëve të lindur jashtë martese me ata të lindur nga martesa.

Në bazë të nenit 20 të ligjit “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*” zyra e gjëndjes civile ndalohet që të refuzojë ofrimin e shërbimeve në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme për shkak të statusit si fëmijë i lindur jashtë martese.

Sjellim në vëmendjen tuaj se mosmarrja në shqyrtim dhe moskthimi i përgjigjes për shqetësimin për diskriminimin e fëmijëve të lindur jashtë martese, është në kundërshtim me parashikimet e ligjit “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”. Në pikën 1, të nenit 5 të ligjit parashikohet : “*1. Ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.*”

Sa më sipër dhe bazuar në ligjin “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, duke mbajtur në konsideratë legjislacionin e brendshëm dhe atë ndërkontaktor të ratifikuar nga vendi ynë për garantimin e të drejtave të fëmijëve, por edhe legjislacionin për gjëndjen civile, vlerësojmë se praktika e ndjekur nga ana juaj, i vendos fëmijët e lindur jashtë martesë në pozita të pabarabarta në raport me fëmijët e lindur nga martesa dhe se identiteti i tyre nuk garantonohet në baza të barabarta me këta të fundit. Shërbimi i ofruar nga zyra e gjëndjes civile duke lëshuar çertifikatën e lindjes përfundimtare fëmijën e mitur të lindur jashtë martese me shënimin “Xx” tek rubrika e përpërësit të gjëndjes civile ku përcaktohet emri i babait, nuk jepet në mënyrë të barabartë si përfundimtare fëmijët që kanë lindur brenda martesës, të cilët kanë gjithmonë të shënuar emrin e babait në rubrikën përkatëse.



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

Gjithë sa më sipër dhe meqënëse, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile është organi më i lartë i shërbimit të gjendjes civile,

**REKOMANDOJMË :**

Nxjerrjen e udhëzimeve për të gjitha zyrat e gjëndjes civile dhe unifikimin e prakikës nga ana e shërbimit të gjëndjes civile, për trajtimin e rasteve të fëmijëve të lindur jashtë martese, me qëllim mbrojtjen e identitetit të fëmijëve dhe parandalimit të situatave diskriminuese ndaj fëmijëve për shkak të statusit të tyre si fëmijë të lindur jashtë martese.

Ju lutemi të na informoni brenda 30 ditëve lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij rekondimi.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin.



Adresa: Rrugë Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)